

Fjala është fjalë!

Si implementohet Marrëveshja e Përzhinos?

МРЕЖА

23

Botues:
Институт за Политикë Evropiane (EPI) – Shkup

Për botuesin:
Dr. Malinka Ristevska Jordanova


Dizajni:
Gaja Dizajn

Projekti “Rrjeti 23: Monitorimi i Prioriteteve të Reformave Urgjente” mbështetet nga Mbretëria e Holandës. Opinonet e prezantuara në këtë dokument janë opinione të autorëve dhe nuk i pasqyrojnë çdoherë opinonet e donatorit.



Kingdom of the Netherlands

Ky publikim është hartuar në bazë të monitorimit mbi implementimin e Prioriteteve të Reformave Urgjente përmes “Rrjetit 23” duke i përfshirë edhe anëtarët e Rrjetit, si vijojnë:



Përmbajtja

Rreth Marrëveshjes	4
Roli i bashkësisë ndërkombëtar: pritje (tepër) të mëdha?	5
Qëllimet dhe parimet e Marrëveshjes	5
(Mos) implementimi	6
Qeveri për organizimin e zgjedhjeve	6
Kthimi i LSDM në Kuvend	7
Zgjidhja e skandalit me përgjimet	7
-Trajtimi i materialeve të përgjuara	7
-Prokuroria Publike Speciale	7
-Roli mbikëqyrës i Kuvendit	8
Implementimi i rekomandimeve të KE për reformat	9
Organizimi i zgjedhjeve dhe organet zgjedhore	10
-Vonesa në afat të shkurtër – rreziqe në afat të gjatë.....	10
-Nus-produktet e Marrëveshjes	10
-Konkluzione dhe rekomandime	11

Marrëveshja politike e Përzhinos,¹ ose Marrëveshja e qershorit/korrikut, siç parapëlqejnë ta emërtojnë përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare, është edhe një Marrëveshje me nënshkrimet e liderëve të katër partive më të mëdha politike maqedonase me qëllim të zgjidhjes së krizës politike, me ndihmën e faktorit ndërkombëtar.²

[Marrëveshja përbëhet nga:]

Teksti bazik i Marrëveshjes së 2 qershorit të vitit 2015;
Aneks Marrëveshja nga data 19 qershor të vitit 2015;
Protokolli i Marrëveshjes së 2 qershorit, nga 15 korriku i vitit 2015;

Për shkak të mospjesëmarrjes, më 2 qershor, të arrihet marrëveshje rreth çështjeve kyçe për përbërjen e “Qeverisë në periudhën kalimtare”, Aneks Marrëveshja e përcakton vazhdimin e negociatave, ndërsa kthimin e opozitës në Kuvend e ndërlikon me arritjen e marrëveshjes për përbërjen e Qeverisë. Përfundimisht, Protokolli i Marrëveshjes i zgjidh çështjet më kontestuese të përbërjes së “Qeverisë në periudhën kalimtare”.

Nënshkrues të Marrëveshjes janë liderët e katër partive më të mëdha politike në Republikën e Maqedonisë: VMRO-DPMNE, LSDM, BDI dhe PDSH. Në të tre pjesët e Marrëveshjes qëndrojnë vetëm nënshkrime – nuk figurojnë emrat e nënshkruesve dhe as të partive të tyre, të cilët përmenden në dispozitat e Marrëveshjes.

Partitë janë zotuar të sigurojnë përfshirje në implementimin e Marrëveshjes, përmes koordinimeve dhe konsultimeve me “partitë kryesore në vend” (t. 2.). Marrëveshja, mes tjerash, proklamoi transparencë “për nënshkrimin e partive politike të interesuara”, megjithatë një përfshirje dhe transparencë të këtillë nuk pati gjatë implementimit të Marrëveshjes. Përkundrazi, edhe negociatat edhe implementimi u zhvilluan me pjesëmarrje ekskluzive të katër partive më të mëdha. Për shkak të pamundësisë që të marrin pjesë në tryezën e negociatave, për shembull, për çështje që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, një pjesë e partive më të vogla politike, me një letër të përbashkët, iu drejtuan ambasadorëve të SHBA dhe BE dhe i prezantuan qëndrimet e tyre për këto çështje. Edhe pse për një pjesë të temave u konsultuan ekspertë dhe organizata qytetare, megjithatë, në formatin e negociatave – “katërshja e liderëve + mediatori + monitorues/garantues”, nuk kishte vend për partitë e tjera e as për përfaqësuesit e sektorit civil, madje as në situatat ad-hok.

¹ Emërtim i fituar sipas toponimit të lagjes në Shkup në të cilën është nënshkruar.

² Raporti i KE e përshkruan krizën duke e përdorur këtë vokabular: Këtë vit Republika e Maqedonisë u përball me krizën më të vështirë politike nga viti 2001. Kultura politike e ndarjeve, mungesa e kompromisit dhe dështimi i dialogut politik e morën formën e krizës politike në kontinuitet dhe të vazhduar, duke e përfshirë edhe bojkotimin e Kuvendit nga partia kryesore opozitare dhe erozioni shtesë. Kriza në mënyrë plotësuese u thellua me publikimin e bisedave të përgjuara, përfshirë këtu edhe bartësit e funksioneve të larta në Qeveri e që vinin në dukje shkeljen e të drejtave fundamentale, ndikimin mbi pavarësinë e gjyqësorit, lirinë e medias dhe zgjedhjeve, politizimin dhe korrupsionin në segmente të ndryshme..

[Roli i bashkësisë ndërkombëtare: pritje (tepër) të mëdha?]

Roli i fuqishëm, të cilën bashkësia ndërkombëtare e kishte në arritjen dhe implementimin e Marrëveshjes, nuk është i dukshëm në dispozitat e saj. Madje, edhe vet përfaqësuesit e BE-së, SHBA-ve dhe shteteve anëtare të BE-së, rolin e tyre e përshkruajnë kryesisht si “ndihmë” ose “mbështetje” në zgjidhjen e krizës politike.³ Kjo mund të shpjegohet edhe me mospasje vullnet nga ana e tyre, deri në ngjarjet e Kumanovës të datës 9 dhe 10 maj 2015, më thellësisht të përfshihen në zgjidhjen e krizës.

Në praktikë u dëshmuua se realizimi i Marrëveshjes, në masë të madhe, varet pikërisht nga përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare, të cilët ushtronin presion të fuqishëm diplomatik në çdo çast kritik gjatë negociatave, si dhe gjatë vet procesit të implementimit. Bashkimi Evropian është përfshirë në zgjidhjen e krizës përmes Komisionerit për Marrëdhënie të Mira Fqinjësore dhe Negociata për Zgjerim Johanes Han, i cili brenda periudhës kohore nga muaji qershor deri në muajin dhjetor katër herë e vizitoi Maqedoninë. Vizitat e tij çdoherë kishin të bëjnë me momente të rëndësishme dhe të vështira të “bllokimit”, përkatësisht para skadimit të afatit të fundit për përmbushjen e zgjidhjeve të caktuara të parashikuara me Marrëveshjen. Komisioni Evropian angazhoi ekspertë si mediatorë/ndërmjetësues për implementimin e Marrëveshjes. Periodikisht, gjatë negociatave inkuadrohen eurodeputetët Eduar Kukan, Riçard Hovit dhe Ivo Vajgël – kryesisht si pararoja të Komisionerit. Në emër të SHBA-ve, përveç Ambasadorit u përfshi edhe Ndihmës Sekretarja Shtetërore Viktoria Nulland.

Në të vërtetë, barrën kryesore gjatë implementimit të Marrëveshjes nga bashkësia ndërkombëtare e ka mediatori Piter Vanhoute. Procesi i ndërmjetësimit e përfshinte edhe ndikimin e drejtpërdrejt në formulimin e ligjeve të cilët rezultuan nga Marrëveshja. Fillimisht, i përmbajtur në raport me publikun, Vanhoute nga muaji shtator i intensifikoi kontaktet veçanërisht me mediat. Në të vërtetë, ai ishte burimi më relevant i rrjedhës së negociatave dhe implementimit të Marrëveshjes.

[Qëllimet dhe parimet e Marrëveshjes]

Edhe pse vet Marrëveshja nuk ka strukturë të veçantë dhe nënseksione, nga përmbajtja mund të shihet se katër pikat e para, si dhe pika e fundit e Protokollit i përcaktojnë parimet dhe qëllimet e saj:

[Parimet për cilat partitë politike kanë rënë dakord janë:]

Veprimi në interes të të gjithë qytetarëve dhe të gjitha bashkësive;
Përkushtimi ndaj proceseve euroatlantike dhe parimeve demokratike;
Respektimi i parimit demokratik për përgjegjësi politike;
Përfshirja e të gjitha partive kryesore politike, përmes procesit të konsultimeve dhe koordinimit;
Respektimi i Marrëveshjes me vullnet të plotë dhe të mirë; shmangia e pengesave të reja, përfshirë edhe ato në lidhje me mbajtjen e zgjedhjeve më 24 prill të viti 2016.

Qëllimi kryesor i Marrëveshjes është “vendi të ecë përpara në rrugën euroatlantike”.

³Ambasadori amerikan Xhes Bejli më 15 korrik e përshëndeti Marrëveshjen e arritur midis liderëve partiak për tejkalimin e krizës politike në Maqedoni: “Maqedonia fitoi. Kam dëshirë t'i lavdëroj liderët për Marrëveshjen e arritur dhe qytetarët i vendosën para interesave politik të partive. Vet Marrëveshja do të thotë shumë punë, ndërsa përmbushja e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nënkupton se Maqedonia fuqimisht do të përafrohet kah NATO dhe BE. Ju siguroj se SHBA bashkë me partnerët tanë BE dhe OSBE do të jemi bashkë që ta ndihmojmë Maqedoninë në progresin e saj”.

Që të arrihet kjo, partitë bien dakord që të punojnë në zgjidhjen e sfidave kryesore, me të cilat përballet vendi:

të konsolidohet zhvillimi ekonomik dhe demokratik;
të përforcohen marrëdhëniet ndëretnike;
të sigurohet implementimi i plotë i Marrëveshjes së Ohrit;
të përforcohen marrëdhëniet e mira fqinjësore;
të përforcohet reputacioni ndërkombëtar i vendit.

Në të vërtetë, me formulimin e këtillë, është bërë përpjekje që të identifikohen (në mënyrë të përgjithshme) problemet kryesore me të cilat ballafaqohet shteti. Duke e pasur parasysh faktin se bëhet fjalë për tekst kompromisi, shkaku i vërtetë heshtet. Realisht, kjo ka të bëjë me mosfunksionimin e rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë dhe rrjedhimisht me këtë edhe rreziku nga një krizë akoma më e madhe, duke e përfshirë edhe krizën me karakter ndëretnik me potenciale për përhapjen e saj në rajon.

Si "mekanizëm" Marrëveshja parashikon zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe "periudhë kalimtare", e cila duhet të sigurojë kushte për zgjedhje të lira dhe të ndershme në përputhje të plotë me standardet evropiane. Data e zgjedhjeve është përcaktuar me Protokollin e Marrëveshjes – 24 prill 2016.

(Mos) implementimi

1. Organizimi i Qeverisë për implementimin e zgjedhjeve;
2. Kthimi i LSDM në Kuvend;
3. Zgjidhja e skandalit me përgjimet;
4. Implementimi i rekomandimeve të KE për reformat;
5. Organet zgjedhore dhe organizimi i zgjedhjeve.

[Qeveri për organizimin e zgjedhjeve]

Nuk është shmangur vetëm termini, por në esencë, formimi i "Qeverisë kalimtare". Kompromisi i arritur është: a) në fazën e parë – pjesëmarrje e kufizuar e opozitës në Qeveri (vetëm LSDM), në disa ministri që konsiderohen të rëndësishme për organizimin e zgjedhjeve, b) në fazën e dytë – tërheqja e kryeministrit dhe caktimi i kryeministrit të ri, me propozim të partisë së njëjtë në pushtet – VMRO-DPMNE.

Faza e parë u realizua me vonesë prej 18 ditësh. Divergjencat kryesore ishin rreth autorizimeve të ministrave dhe zëvendësministrave të sapoemëruar, si dhe sa i përket të drejtës së vetos së zëvendësministrave shtesë, me ç'rast VMRO-DPMNE përpikëj që të reduktohen autorizimet e ministrit të Punëve të Brendshme. (Funksion i cili e nënkupton reterimin më të rëndësishëm të pushtetit në këtë fazë).

Divergjencat formalisht u tejkaluan përmes presionit të fuqishëm ndërkombëtar, me ç'rast me procedurë të shkurtuar u ndryshua Ligji për Qeveri. Në praktikë tanimë ka tone divergjente rreth zbatimit të Ligjit. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) e shfuqizoi veton e zëvendësministrit shtesë të Financave (nga LSDM) lidhur me vendimin e huamarrjes së ministrit të Financave. Së këtejmi, LSDM ngriti kontest administrativ, meqë KSHZ vendimin për shfuqizimin e vetos e miratoi në kohën kur mandati i tij kishte skaduar, ndërsa përbërja e re, në përputhje me Marrëveshjen, u formua kah fundi i muajit dhjetor të vitit 2015.⁴

Puna e ministrave dhe zëvendësministrave shtesë në ministritë në të cilat ata janë zgjedhur është konfliktuoze, konfrontuese dhe mbikëqyrëse, me mosmarrëveshje të shpeshta në publik. "Komunikimi" i këtillë ndikon negativisht mbi punën e institucioneve dhe është në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e proklamuar të Marrëveshjes.

⁴ Padi e paraqitur për shkak të vendimit të paligjshëm të ish- përbërjes së KSHZ. Ueb-faqja e LSDM. 22.12.2015. E aksesshme në: <http://www.sds.org.mk/default.aspx?mld=55&agld=2&articleId=13224>.

Sipas hapave që janë ndërmarrë deri më tani, njëri nga prioritet kryesorë të ministrave dhe zëvendësministrave shtesë nga radhët e LSDM, mesa duket është zbulimi i krimit nga ana e pushtetit, për çka dëshmojnë kallëzimet penale të ngritura dhe deklaratat publike.⁵

Tërheqja e kryeministrit aktual dhe caktimi i kryeministrit të ri nga radhët e VMRO-DPMNE është pika e radhës, përkatësisht e fundit kryesore dhe kritike e Marrëveshjes, e cila tani problematizohet, duke i pasur parasysh debatet transparente për nevojën e prolongimit të datës së zgjedhjeve, për shkak të vonesave gjatë implementimit të obligimeve të Marrëveshjes.

[Kthimi i LSDM në Kuvend]

LSDM-ja u kthye në Kuvend në afatin e parashikuar – më 1 shtator të vitit 2015 dhe pas kësaj trupat punuese në Kuvend u kompletuan edhe me përfaqësuesit e tyre.

[Zgjidhja e skandalit me përgjimet]

a) Trajtimi i materialeve të përgjuara

LSDM-ja e respektoi obligimin pas nënshkrimit të Marrëveshjes të mos publikojë materiale të përgjuara. Megjithatë, LSDM ia dorëzoi materialet Prokurores Publike Speciale madje 15 ditë pas kërkesës së saj, me arsyetimin se paraprakisht nuk ka pasur kushte që ato të trajtohen në mënyrë përkatëse.

Jashtë dispozitave të Marrëveshjes dhe në kundërshtim me atë për të cilën kanë rënë dakord gjatë negociatave, deputetët e koalicionit në pushtet VMRO-DPMNE dhe BDI, Kërsto Mukoski dhe Talat Xhaferi, paraqitën Propozim-Ligj për ndalimin e posedimit, trajtimit, publikimit dhe pasjes në dispozicion të materialeve të cilat rezultojnë nga ndjekja e paligjshme e komunikimeve, me procedurë të shkurtuar, i cili përmbante elemente të censurës. Kjo shkaktoi reagime të shumta në publik, veçanërisht në sektorin civil.

Pas intervenimit të komunitetit ndërkombëtar, propozuesit e koalicionit në pushtet e revokuan Propozim-Ligjin, ndërsa me propozim të mediatorit Vanhoute u miratuan dy ligje – Ligji për mbrojtjen e privatësisë dhe Ligji për mbrojtjen e denoncuesve.

b) Prokuroria Publike Speciale

Funksionimi i Prokurorisë Publike Speciale mbetet pjesa më pozitive e implementimit të Marrëveshjes së Përzahinos, përkundëjt obstrukcioneve, si në lidhje me caktimin e prokurorëve të propozuar (nga ana e Këshillit të Prokurorëve Publikë), ashtu edhe në lidhje me sigurimin e kushteve të plota për punën e kësaj Prokurorie (nga ana e Qeverisë).

⁵ Mbikëqyrje e jashtëzakonshme inspektuese në Qendrat për punë sociale. Ueb-faqja e MPPS. 9.12.2015. E aksesshme në: http://www.mtsp.gov.mk/pocetna-ns_article-vonreden-inspekckiski-nadzor-vo-centrite-za-socijalni-raboti.nspx; Remenski ngriti kallëzim penal kundër Spasovit. MIA. 28.12.2015. E aksesshme në: <http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/134/132964460>; Ministri Spasovski mbajti konferencë për shtyp dhe briefing me gazetarët. Ueb-faqja e MPB. 7.12.2015. E aksesshme në: <http://www.mvr.gov.mk/vest/1009>; Komunikatë për publikun. Ueb-faqja e MPB. 10.12.2015. E aksesshme në: <http://www.mvr.gov.mk/vest/1034>; Filojmë me zbulimin e abuzimeve. Ueb-faqja e LSDM. 4.12.2015. E aksesshme në: <http://www.sdsm.org.mk/default.aspx?mld=55&agId=5&articleId=13031>.

Edhe përkrah tentativave të vazhdueshme të pushtetit që ta cenojë parimin e autonomisë të kësaj Prokurorie,⁶ ky institucion i ri i respektonte afatet ligjore dhe gjatë ndërmarrjes së parë vendosi kompetencë materiale mbi 34 lëndë, përfshirë këtu edhe lëndën e rastit “Puç”. Prokuroria u dha prioritet pesë lëndëve, në mesin e të cilave edhe për rastin “Puç”.

“Shpatë e Demokleut” mbi punën e Prokurorisë Speciale është kërkesa e paraqitur për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për themelimin e saj. Kërkesa akoma nuk është shqyrtuar në seancë të Gjykatës Kushtetuese.

c) Roli mbikëqyrës i Kuvendit

Edhe pse opozita kryeson edhe me Komisionin për Mbikëqyrjen e Punës së Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencisë për Zbulim dhe Komisionin për Mbikëqyrje mbi Zbatimin e Masës së Veçantë Hetuese, Ndjekja e Komunikimeve nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë së Policisë Financiare, Drejtorisë së Doganave dhe Ministrisë së Mbrojtjes dhe me Komisionin Anketues për Skandalin me Përgjimet, nuk ka rezultate reale nga puna e këtyre komisioneve. Komisionet nuk kanë paraqitur raporte preliminare, të cilat ishin planifikuar për muajin nëntor.

Negociatat, për harmonizimin e qëndrimeve në lidhje me Rregulloren e Komisionit Anketues, veçanërisht dispozitave sa i përket transparencës, morën më shumë kohë për harmonizim. Në thirrjen për të dëshmuar para Komisionit, siç deklaroi kryetari i Komisionit Petre Shilegov, nuk janë përgjigjur fare ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Mile Janakievski, ish-ministrja e Punëve të Brendshme, Gordana Jankulovska, shefi i kabinetit të Kryeministrit, Martin Protugjer dhe ish-drejtori i Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, Sasho Mijallkov, ndërsa Kryeministri Gruevski dëshmitë e veta i dha pas dyerve të mbyllura. Përveç Kryeministrit, i vetmi që iu përgjigj thirrjes ishte ministri i Financave – Zoran Stavrevski, por njësoj sikurse edhe Gruevski edhe ai kërkoi që mbledhja të jetë e mbyllur për publikun. Me këtë u humb kuptimi i ekzistimit të Komisionit Anketues, puna publike⁷ dhe transparente e të cilat duhej të kontribuonte në përcaktimin e përgjegjësisë politike për përgjimet, si njëri nga qëllimet e Marrëveshjes.

⁶ Në reagimin e vet ndaj Propozim-Ligjit për pagat e prokurorëve publikë, Prokurorja Publike Speciale, Janeva vlerësoi se me dispozitat me të cilat e autorizon Prokurorin Publik të RM, sipas pëlqimit paraprak të ministrit të Financave, të vendos për shtesat në pagë të prokurorëve publikë në këtë Prokurori Publike, shkelen parimet tanimë të vendosura të autonomisë dhe pavarësisë financiare. Pastaj, Qeveria paraqiti Propozim-Ligj të plotësuar, i cili parashikon se shtesat në pagë, lartësia e tyre dhe mënyra e përcaktimit për Prokurorinë Publike Speciale rregullohen me akt të Prokurorit Publik i cili udhëheqë me të.

Pas zvarritjes së gjatë, Kuvendi i RM-së, më datë 30 dhjetor, e miratoi Propozim-Ligjin për të punësuarit në shërbimin e Prokurorisë Publike të Prokurorisë Publike për Ndjekjen e Veprave Penale të ndërlidhura dhe të cilat rezultojnë nga përmbajtjet e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve, i paraqitur nga Qeveria me procedurë të shkurtuar. Propozimi, fillimisht u paraqit më datë 21 dhjetor nga ana e deputetëve nga radhët e LSDM, PRSD, PLD, PDT, por nuk arriti në rend dite meqë deputetët e VMRO-DPMNE votuan kundër, me arsyetimin se kjo materie tanimë është rregulluar me ligjet e tjerë për Prokurorinë Publike, Shërbimin e Prokurorisë Publike dhe Administratën dhe me Ligjin e propozuar kjo Prokurori do të ishte në pozitë të favorizuar.

Më 25 dhjetor, deputeti nga radhët e VMRO-DPMNE, Antonio Milloshoski, deklaroi se partia e tij “shpreh rezervë serioze” sa i përket veprimeve të Prokurores Publike Spëciale, Katica Janeva, e cila “u shndërrua në instrument klasik të Zoran Zaevit”. Deklarata është e aksesshme në: <http://vmro-dpmne.org.mk/?p=28618>.

⁷ Kryetari i Komisionit Anketues, Petre Shilegov, me qëllim që ta motivojë që të dëshmojë publikisht, para fillimit të mbledhjes ministrit Stavreski ia lexoi pyetjet që do t'i parashtrohen. Pasi që Stavreski nuk pranoi të dëshmojë në mbledhje të hapur, Shilegovi e ndërpreu mbledhjen, me qëndrimin se punimet e Komisionit nga VMRO-DPMNE janë shndërruar në farsë.

Shilegov: “Publikisht ua kumtoj orarin e dëshmitarëve në lidhje me përgjimet e paligjshme”. Ueb-faqja e LSDM. 7.12.2015. E aksesshme në: <http://www.sds.org.mk/default.aspx?mld=55&agld=6&articleld=13072>.

[Implementimi i rekomandimeve të KE për reformat]

Nga Marrëveshja nuk është e qartë se në cilën formë duhet të arrihet “marrëveshje” për reformat në fushën e Kapitujve 23 dhe 24. Plan Veprimi i paralajmëruar i Qeverisë për realizimin e Prioriteteve të Reformave Urgjente nuk është publikuar, madje as që dihet statusi i tij. Nuk u organizua as debat publik në Kuvend, ashtu siç sugjeroi KE. Vetëm Këshilli Nacional për Eurointegritim mbajti debat publik për implementimin e Prioriteteve të Reformave Urgjente, por pa u thelluar në analizën e asaj që është implementuar.

Kjo është pika e vetme e Marrëveshjes në të cilën parashikohet obligim për BE – ta lehtësojë Marrëveshjen, e që realizohet përmes ekspertit – mediatorit Vanhoute. Afati i dialogut që moti ka skaduar, por akoma nuk janë arritur rezultate.

Nuk zbatohen rekomandimet e Komisionit Evropian për çështje sistematike të sundimit të së drejtës – Prioritetet e Reformave Urgjente.⁸

[Dialogu duhet të zhvillohet në mënyrë të strukturuar në fusha tematike të përfshira në Prioritetet e Reformave Urgjente:]

- Sundimi i së drejtës dhe jurisprudenca;
- Depolitizimi i administratës publike;
- Reformat zgjedhore;
- Mediat.

Veçanërisht kritike, nga aspekti i sigurimit të kushteve për zgjedhje të ndershme, është gjendja e mediave, të cilat janë nën kontrollin e pushtetit. Këtë e vë në dukje edhe analiza e ResPublica, sipas së cilës vërehet ngjashmëri e madhe gjatë përzgjedhjes së temave dhe burimeve të informatave, si dhe vënia në kornizë të lajmeve që prezantohen në servis publik, Sitel, Alfa dhe në Kanal 5. Përveç kësaj, analiza vë në dukje edhe ekzistimin e gjuhës së urrejtjes, gjuhës diskriminuese dhe negative dhe mosrespektimin e Kodeksit të gazetarëve. Edhe pse negociatat për reforma në sektorin mediatik kanë filluar, ato akoma nuk japin rezultate.⁹

Është fakt se për implementimin e Prioriteteve të Reformave Urgjente – u mbajtën konsulta në një takim dy-orësh të Komisionerit Han me përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët paraprakisht në organizim të Delegacionit të Komisionit Evropian, i artikuluan qëndrimet e tyre në kuadër të grupeve tematike. Paralelisht me këtë, konsultime organizoi edhe Nënkryetari i Qeverisë për Çështje Evropiane. Edhe pse këto hapa ishin pozitiv, megjithatë nuk vazhdoi dhe nuk u zhvillua më tutje praktika dhe formati i konsultimeve.

⁸ Realizimi i Prioriteteve të Reformave Urgjente është analizuar në një dokument të veçantë të “Rrjetit 23”: “Prioritetet e Reformave Urgjente më të ngathëta se restaurimi i praktikave joreformiste”.

⁹ E aksesshme në: http://www.respublica.edu.mk/images/modem/attach/MODEM-eden_18%20noemvri%20_23%20dekemvri.pdf

Në mënyrë plotësuese: SHGM: Analiza e sistemit të mediave në Maqedoni, shtator 2015, e aksesshme në: http://www.znm.org.mk/drupal7.7/sites/default/files/Analiza%20mediumski%20sektor%20MK%20septemvri%202015_0.pdf

[Organizimi i zgjedhjeve dhe organet zgjedhore]

Kjo pjesë e implementimit të Marrëveshjes merr shumë kohë dhe energji në krahasim me rezultatin e fundit – ndryshime të Kodit Zgjedhor me të cilat sigurohet minimumi i nevojshëm për implementimin e Marrëveshjes së Përzahinos.

Realizimi i obligimeve kryesore prej të cilave varet zbatimi i zgjedhjeve demokratike, në masë të konsiderueshme u vonua. Kjo, para së gjithash, ka të bëjë me zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, të cilët u zgjodhën më datë 15 dhjetor të vitit 2015, madje me 137 ditë vonesë.

Është pikëpyetje se në ç' masë ky Komision do të ketë sukses t'i realizojë kompetencat e zgjeruara, veçanërisht duke e pasur parasysh kulturën tanimë të vendosur të ndarjeve të këtij Komisioni në baza partiake, në vend të ndërtimit të identitetit institucional që do të mbështetet mbi respektimin e standardeve demokratike të zgjedhjeve dhe besimit të ndërsjellë.

Njëri nga kushtet kyç për zgjedhje të ndershme – revizioni i Listës së Zgjedhësve as që ka filluar. Është evidente rezistenca politike ndaj këtij obligimi, meqë sipas rekomandimeve të OSBE/ODIHR, kjo punë është dashur të kryhet para disa vitesh. Lista e saktë e Zgjedhësve është njëri nga kriteret kryesor për këto zgjedhje. Pas zbulimit të parë të lëshimit të paligjshëm të letërnjoftimeve dhe pas publikimit të aferës së mjegullt "Letërnjoftime të falsifikuara", MPB kumtoi se pas një hetimi të realizuar, deri më tani janë zbuluar 424 raste të lëshimit të paligjshëm institucional të letërnjoftimeve për banorët e Pustecit, Shqipëri.¹¹ Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, në një konferencë për shtyp njoftoi se të punësuarit në Drejtorinë për lëshimin¹⁰ e letërnjoftimeve kanë pranuar se lëshimin e paligjshëm e kanë bërë me urdhër të eprorëve të tyre.

Me rëndësi thelbësore është që aktivitetet e mëtutjeshme në lidhje me organizimin e zgjedhjeve dhe organeve zgjedhore të rezultojnë me sigurimin e kredibilitetit të zgjedhjeve, ndërsa partitë kryesore politike t'i njohin rezultatet e zgjedhjeve. Ky është faktori kryesor për suksesin e Marrëveshjes. Në të kundërtën zgjedhjet "kontestuese" do të jenë uverturë në një krizë akoma më të thellë politike.

[Vonesa në afat të shkurtër – rreziqe në afat të gjatë]

Vonesa mesatare gjatë implementimit të obligimeve të Marrëveshjes është 43,44 ditë. Është simptomatik fakti që pjesa më e madhe e vonesave ka të bëjë me funksionimin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe me zbatimin e Prioriteteve të Reformave Urgjente.

[Nus-produktet e Marrëveshjes]

Si masë urgjente për zgjidhjen e krizës politike, implementimi i Marrëveshjes vetvetiu nuk e nënkupton kthimin e proceseve demokratike. Përkundrazi, Marrëveshja rezultoi me atë që vendimet të miratohen në një rreth të ngushtë të elitave partiake, me ndërmjetësimin e komunitetit ndërkombëtar. Të gjitha ligjet e domosdoshëm për implementimin e Marrëveshjes u miratuan me procedurë të shkurtuar. Qytetarët, në masë të madhe janë të shkyçur nga procesi. Në të vërtetë, implementimi i Marrëveshjes ka një "deficit të inkorporuar demokratik" dhe çoi në substitucionin e demokracisë, e që mund të ketë pasoja të mëdha negative.

¹⁰ Konferencë për shtyp e ministrit Spasovski; Persona pa vendbanim janë pajisur me letërnjoftime dhe kanë qenë në Listën e Zgjedhësve. Ueb-faqja e MPB. 23.12.2015. E aksesshme në: <http://www.mvr.gov.mk/vest/1143>; [Letërnjoftimet e kundërligjshme të banorëve të Pustecit me adresë në apartamente në pronësi të RM-së. Ueb-faqja e MPB. 30.12.2015. E aksesshme në: http://www.mvr.gov.mk/vest/1186.](http://www.mvr.gov.mk/vest/1186)

[Konkluzione dhe rekomandime:]

Konkluzione:

1. Marrëveshja e Përzhinos zbatohet pjesërisht dhe me ndikim vendimtar të bashkësisë ndërkombëtare për implementimin e dispozitave kryesore të saj.
2. Nuk respektohen në mënyrë thelbësore obligimet që i kanë ndërmarrë partitë nënshkruese, veçanërisht partitë në pushtet: të veprohet në interes të qytetarëve, si dhe të ndërmerret përgjegjësi politike duke i respektuar standardet demokratike. Përkundrazi, vazhdon realizimi i strategjisë për kontrollin e plotë të institucioneve shtetërore.
3. Parimet e Marrëveshjes nuk respektohen në mënyrë thelbësore.
4. Për suksesin e Marrëveshjes, me rëndësi esenciale është që procesi të rezultojë me zgjedhje kredibile, si dhe rezultatet e zgjedhjeve të njihen nga partitë kryesore politike.
5. Me implementimin e deritanishëm të Marrëveshjes, nuk janë siguruar kushte për zgjedhje të ndershme. Parakushtet më të rëndësishme të parealizuara për zgjedhje të ndershme janë:
 - pastrimi i Listës zgjedhore;
 - informimi objektiv i mediave.

Rekomandime:

1. Obligimet tjera nga Marrëveshja, për organizimin e Qeverisë – dorëheqja e Kryeministrit aktual dhe caktimi i kryetarit të Qeverisë nga VMRO-DPMNE të realizohet në afatin e parashikuar – 15 janar të vitit 2016.
2. Me ndërmjetësimin e komunitetit ndërkombëtar, të nënshkruhet Aneks ndaj Marrëveshjes, në të cilin do të përcaktohen afate dhe obligime të qarta për:
 - pastrimin e Listës zgjedhore;
 - informimin objektiv nga ana e të gjitha mediave, jo vetëm gjatë fushatës parazgjedhore.Nevojitet monitorim ekspert ndërkombëtar për zbatimin e këtyre masave.
3. Është e domosdoshme, me përfshirjen e shoqatave të gazetarëve, të bëhen ndryshime përkatëse në Ligjin për media dhe Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audivizive, të cilët do të sigurojnë informim objektiv dhe të balancuar, jo vetëm gjatë periudhës parazgjedhore, por në afat të gjatë.
4. Zhvendosja e afatit eventual të zgjedhjeve të ndërlidhet me:
 - Datën e përfundimit të pastrimit të Listës zgjedhore, që do të konstatohet me ndërmjetësimin e OSBE/ODIHR;
 - Fillimin e monitorimit objektiv mbi informimin e mediave.
5. Komisioni Evropian rregullisht e informon publikun sa u përket dhënave të tyre lidhur me shkallën e implementimit të Marrëveshjes.

Fjala është fjalë!



Instituti
për
politikë
evropiane.
Shkup